

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Kosova i kërkon dorëheqjen, ministrja: S'kam bashkëpunuar me Hagën për dënimin e 4 ish-krerëve të UÇK-së
ADRESA	https://www.gazetatema.net/rajoni/kosova-i-kerkon-doreheqjen-ministrja-skam-bashkepunuar-me-hagen-per-denim-i588667
BURIMI	gazetatema.net
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	27 shtator 2026, 08:17:02 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	27 shtator 2026, 08:50:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	89861440956cdd760c8bb7505e31fde8c37c4a16b9bd8a7e6d7604c6a2df42e8
TEKSTI	241c96213cd0b728d1a53be5bb27012ed24e289769c276e2aebe5368fe8facc6
PAMJA	c1253004719324b880c920a85ccaddcc577d5aca4ff7ffe850b4424896e9bd8b

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	d5ab5b91936a005d96ed7f2c886668cc7671090e38d221c6b5ffcac54ed1d003
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	f fa3671555d7ae6cb03bad74ec6398ad3819e03f2270ea6128c9f6d225eb63a8
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/d5ab5b91936a005d96ed7f2c886668cc7671090e38d221c6b5ffcac54ed1d003>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [Politika](#)
- [Sociale](#)
- [Kronika](#)
- [Ekonomia](#)
- [Editorial](#)
- [Antena](#)
- [Blog](#)
- [Rajoni](#)
- [Bota](#)
- [Kulturë](#)
- [Sport](#)
- [Lifestyle](#)
- [Hosteni](#)

English

Built and Monetized by

English

Alarm per eksplozivë prane bazës ajrore në Britani, arrestohen disa persona, evakohen banoret Suim vetevrases në një pikë kontrolli në Pakistan, të paktën 11 viktima

Kosova i kërkon dorëheqjen, ministrja: S'kam bashkëpunuar me Hagën për dënimin e 4 ish-krerëve të UÇK-së



27 Shtator 2026, 10:50Rajoni TEMA



Ministrja e Drejtësisë e Kosovës, Donika Gërvalla, mohoi se ka bashkëpunuar me Dhomat e Specializuara të Kosovës dhe tha se deklarata të tilla tashmë janë bërë "bozë". Ajo u shpreh se që nga dita e aktgjykimit ndaj katërsesh së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, po punon për instancën e radhës, atë të apelimit të vendimit.

Në një konferencë për media në Prishtinë më 26 shtator, Gërvalla po ashtu hodhi poshtë kritikën se ka heshtur ndaj dënimit për krime lufte të katërsesh së UÇK-së.

"Deklaratat që më lidhin mua në çfarëdo forme me bashkëpunimin tashmë janë bërë bozë sepse i kam shpjeguar disa herë. Nuk ka, në asnjë hallkë, as me UNMIK-un, as me EULEX-in, as me Gjykatën Speciale nuk ka asnjë pikëtakim timin as direkt as indirekt. Mirëpo edhe pak durim duhet të kemi sepse aktgjykimi do të vijë shpejt dhe do ta shohim shumë shpejt", tha Gërvalla.

Organizata e Veteranëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës më 18 shtator artikuloi kërkesën drejtuar Qeverisë së udhëhequr nga Albin Kurti për shkarkimin e Gërvallës, mes kritikave për mosdeklarim të saj lidhur me aktgjykimin.

Kreu i kësaj organizate, Hysni Gucati, gjatë një proteste të mbajtur po atë ditë tha se "ne e dimë që Gërvalla ka dorëzuar dokumentacione në Hagë", duke shtuar se kryeministri Albin Kurti "duhet nga sot të largojë nga Qeveria njerëz si ajo".

Akuzat se Gërvalla ka bashkëpunuar me Specialen janë të kahershme, dhe ajo disa herë i kishte mohuar të njëjtat.

"Unë nuk kam heshtur, unë jam ministre e Drejtësisë. Kryeministri ka dhënë një deklaratë në emër të Qeverisë, ndërsa unë së bashku me ekipin tim, qysh ditën e parë i jam futur punës me qëllim që të përgatitemi për një betejë sepse çështja e Gjykatës Speciale është betejë ligjore, nuk është betejë deklaratash në media. Dhe, si betejë ligjore, ne duhet të jemi profesionistë, të mençur, me kokë të ftohtë, pa shumë britma, duhet të përgatitemi për instancën e ardhshme", tha Gërvalla.

Sa i përket thirrjes për dorëheqje apo shkarkim të saj, Gërvalla tha se secili qytetar mund të kërkojë dorëheqjen e ndonjë ministri, pasi Kosova është vend demokratik.

Lidhur me protestat e vazhdueshme kundër vendimit të Dhomave të Specializuara, Gërvalla tha se përveç një “zhgënjimi” në ditën e parë të protestave, pra më 16 shtator, tani ajo janë “dinjitoze” dhe po barten nga qytetarët. Megjithatë, ajo tha se e sheh më të udhës që të punojë për çështjen e apelimit të vendimit sesa të marrë pjesë në protestë.

Ish-epororët e UÇK-së, Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Jakup Krasniqi dhe Rexhep Selimi u dënuan për krime lufte në shkallën e parë të mekanizmit të drejtësisë në Hagë, që njihet edhe si Gjykata Speciale. Mbrojtja ka nisur procedurat e apelimit të aktgjykimit me të cilin iu shqiptuan 81 vjet burgim të katërve, marrë së bashku.

Që atëherë në Kosovë, por edhe në vende të tjera të Evropës po mbahen vazhdimisht protesta kundër vendimit.

Partia Demokratike e Kosovës ka iniciuar në Kuvend një projektligj për ndryshimin e ligjit për Specialen, i cili është proceduar në Qeveri për mendim.

Gërvalla tha se ekipi i ekspertëve në Ministri të Drejtësisë po punon që të japë opinion për këtë çështje.

“Kur ta kemi gati do t’ia dërgojmë Qeverisë opinionin tonë. Nuk do ta vonojmë, shpejt do ta dërgojmë. Por, as nuk duam të nxitohemi e ta paguajmë me cilësi të munguar e gabime të papranueshme. Më shumë sesa për fjalë, kemi nevojë për bashkëpunim e bashkërendim, analizë e ekspertizë me qëllim që në fund të fitojë drejtësia”, tha ministria.

Sipas saj, po analizohet se cilët mekanizma të propozuar janë “funksionalë, e cilët eksperimentalë”, duke shtuar se për këtë çështje, në MD, po punojnë në mënyrë intensive.

Në dokumentin e ndryshimeve të propozuara nga PDK-ja, të cilën e ka parë Radio Evropa e Lirë, kërkohet ndër të tjera, që dënimet më të larta që mund të shqiptohen nga Gjykata në Hagë të jenë 15 vjet burgim dhe që të dënuarit të mund të jenë subjekt i faljes presidenciale.

Nisma është mbështetur nga Aleanca, ndërkaq, Lëvizja Vetëvendosje në pushtet ka thënë se do ta analizojë atë në aspektin juridik, përfshirë edhe përputhshmërinë e tij me kornizën ligjore në fuqi dhe “efektet që një ndërhyrje e tillë eventualisht mund të ketë në këtë fazë të procedurave pranë Dhomave të Specializuara”.

Qeveria e Kosovës është zotuar se do të angazhohet në fazën e Apelit për, siç ka thënë kryeministri Kurti, “korrigjuar” vendimin, e cilësuar si të padrejtë, ndaj katërshes së UÇK-së./REL

Lini një Përgjigje

Koment *

Emër *

POSTOJE KOMENTIN

Tre shqiptarë mes viktimave të raportuara nga shpërthimit në Athinë, reagon Ministria e Jashtme e Shqipërisë

22:40 Rajoni

Nga aleatë të SHBA-së në të pandehur: Pse Uashingtoni e mbështeti Gjykatën Speciale për Kosovën

22:00 Rajoni , 3 komente

Nga tetori, një ndalesë në kufirin Shqipëri-RMV

16:40 Rajoni



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.